

Rregullore

“Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

Në mbështetje të neneve 24, shkronja dh) dhe 84, shkronja b) të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003“Për

Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës nxjerr rregulloren “Për caktimin e shpenzimeve

për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”

Neni 1

Tërheqja e “Formularit të Njoftimit të Përqendrimit”, nga ndërmarrjet pjesëmarrëse të përcaktuara

nenin 12, të Ligjit (që bashkohen, përftojnë kontrollin, si dhe për rastet kur pjesa e ndërmarrjes

preket nga transaksioni i kryer), bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15.000 lekë.

Autorizimi “ Për realizimin e përkohshëm të përqendrimit” i dhënë nga Komisioni, në bazë të

kërkesës së ndërmarrjeve pjesëmarrëse, sipas nenit 60, pika 1, e Ligjit, bëhet kundrejt pagesës

me vlerë 300.000 lekë.

Autorizimi “Për realizimin e përqendrimit” i dhënë nga Komisioni, në përputhje me nenin 56, të

Ligjit, jepet kundrejt pagesës me vlerë 500.000 lekë.

Neni 2

Njoftimi nga ndërmarrjet për përjashtimin e marrëveshjeve, sipas përcaktimeve në nenin 5, 6 dhe

7 të Ligjit, bëhet kundrejt pagesës me vlerë 15.000 lekë.”

Vendimi për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi, i dhënë nga Komisioni, sipas nenit 50 të

Ligjit, jepet kundrejt pagesës me vlerë 500.000 lekë.

Vendimi i dhënë nga Komisioni, për shtyrjen në kohë të përjashtimeve të marrëveshjeve të

përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, jepet kundrejt pagesës me vlerë 300.000 lekë.

Neni 3

Depozitimi dhe shqyrtimi i ankesave pranë Autoritetit të Konkurrencës, që kanë për objekt shkeljet

e nenit 4 (Marrëveshjet e Ndaluar) dhe nenit 9 (Abuzimi me Pozitën Dominuese) është pa

pagesë.

Dhënia e vlerësimeve dhe rekomandimeve nga Autoriteti, në përputhje me nenin 69 të Ligjit,

për çështje që lidhen me konkurrencën, me kërkesën e organeve të administratës qendrore dhe

vendore, bëhet pa pagesë.

Neni 4

Pagesat e parashikuara në nenin 1, pika 1 dhe nenin 2, pika 1 të kësaj rregulloreje do të bëhen në

zyrën e llogarisë të Autoritetit, kundrejt mandat arkëtimit.

Pagesat e parashikuara në nenin 1, pika 2, 3 dhe në nenin 2, pika 2, 3 të kësaj rregulloreje do të

bëhen në llogarinë bankare të Autoritetit, kundrejt mandat arkëtimit.

Neni 5

Të gjitha pagesat e parashikuara në këtë rregullore nuk janë të rimbursueshme.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi menjehere.